



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64 pika (a) dhe (b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 16 të Rregullores së Punës së KQZ-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 10.08.2009 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e Rregullores së Punës së KQZ-së

1. Miratohet Propozimi i Këshillit të Buxhetit dhe Prokurimit i datës 06.08.2009 për ndryshimin Rregullores së Punës së KQZ-së të datës 04.09.2008 si në vijim:
2. Që në Nenin 13.5 të hiqet pika (a), përkatësisht obligimi i Këshillit të Buxhetit dhe Prokurimit që për iniciimin e procedurave të prokurimit për çfarëdo artikulli që kalon vlerën prej (pesë mijë) 5.000 Euro të kërkojë miratimin paraprak të KQZ-së.
3. Përmes kësaj Autorizohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së që të nënshkruajë fillimin e procedurave të prokurimit për çfarëdo artikulli mbi vlerën si në pikën 2 të vendimit, në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit mbi Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
4. Ky vendim hyn në fuqi me datë 10 gusht 2009.

Prishtinë, 10 gusht 2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve